

EPPC Albania kërkon një *Këshillues Shitjesh - Shkodër* për klientin e saj, një ndër institucionet financiare kredidhënëse më të suksesshme dhe të konsoliduara në vend prej më shumë se 2 dekadash.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Identifikon klientë potencialë (individë & biznese) dhe kryen takime me ta me qëllim informimin rreth produkteve dhe kushteve të kredisë;
- Ndërton, mirëmban dhe zhvillon database kërkimore klientësh dhe kryen përditësime periodike të saj;
- Krijon kontakte dhe marrëdhënie me klientë të rinj, mirëmban marrëdhëniet me ata ekzistues duke ju ofruar këshillim financiar dhe suport në zgjidhjen e kërkesave dhe trajtimin e ankesave të tyre;
- Inicion në mënyrë proaktive negociata shitjesh për të arritur objektivat e shitjes;
- Vlerëson rrisqet lidhur me aplikimet për kredi duke konsideruar një seri faktorësh dhe informacioni sipas kategorive dhe sektoreve përkatëse;
- Kryen kontrollet e nevojshme sipas procesit të kredidhënies mbi historikun e kredive të palëve si dhe dokumentacionit përkatës që është pjesë e propozimit për aprovim;
- Kryen analiza financiare dhe referon vendimin në komitetin e kredisë në përputhje me procedurat e kredidhënies;
- Performon mbledhjen e hershme dhe intensive të kredisë dhe ndjek vonesat duke negociuar me klientin, me qëllim normalizimin e pagesës së kredisë;
- Qëndron i përditësuar në lidhje me produktet procedurat dhe politikat e reja, dhe termat dhe kushtet e reja të propozuara nga kompania.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Diplomë Universitare;** *(e preferueshme në Shkencat Ekonomike)*
- **Eksperiencë e mëparshme pune në shitje ose në marrëdhënie me klientë;** *(e preferueshme eksperiencë në institucion bankar/financiar)*
- Aftësi të mira analitike, negociuese, prezantuese, bindëse;
- **Leje drejtimi automjeti.**

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.